



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRI E PLANIMIT DHE ZVLOQJES
DEPARTAMENTI PËR KADASTËRIN DHE PRONË



DEPARTAMENTI PËR
KADASTËRIN DHE PRONË

PRANUAR NE: 09/03/2022
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO: 26/69

Nr. Nr. B:

PËR:	Kryetarin e Komunës së Malishevës – Z. Ekrem Kastrati			
PËRMES:	Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë			
NGA:	Drejtori - Bashkim Krasniqi			
TEMA:	Kërkesë			
Nr. i zyrës:	Lokacioni:	DGJKP - Malishevë	Data:	09/03/22
KËRKESË				X

I ndërtuar

Më Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019) dhe Rregulloren Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, janë përcaktuar procedurat në lidhje me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër për periudhën nga (1) një vit deri në (15) pesëmbdhjetë vite dhe për periudhën afatgjatë më shumë se (15) pesëmbdhjetë vite deri në (99) nëntëdhjetë e nëntë vite). Ndërsa mbetet nën kompetencën e komunave që të hartojnë rregullore në lidhje me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale më pak se një vit.

Prandaj, bazuar në këto autorizime që dalin nga dispozitat ligjore të lartpërmendura kërkoj nga titulli i lartshënuar që ta caktojë një komision për hartimin e kësaj draft rregulloreje me të cilën do të mundësohet dhënia në shfrytëzim e pronës komunale për periudhën kohore më pak se një vit.

Ky komision propozojë që të ketë përbërje prej tre anëtarëve dhe atë zyrtarët si në vijim:

1. Kushtrim Krasniqi
2. Muharrem Morina
3. Fadil Shala

Përberja dhe emrat e anëtarëve të komisionit mund të ndryshojnë varësisht prej vendimit të titullit të lartshënuar.

Shpresojmë që kërkesa jonë të miratohet në një afat optimal.

Adresa: Rr. "Skenderbeu" P nr
24000 Malishevë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Malishevës
Opština Malisevo/Municipality of Malisevo
Drejtoria për Gjeodezi Ksdastër dhe Pronë
Njësia për Komunikim me Publikun



Lista e zyrtarëve të grupit punues për hartimin e RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E
PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS për vitin 2022.

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nr.Tel	Nënshkrimi
1	BASHKIM	KRASNIQI	DEJTOR I KADASTEIT	045-222-337	
2	Merina	Udhëheqëse	Udhëheqëse e Komitetit	045-572-582	
3	Fadil	Udhëheqëse	Udhëheqëse e DSHP	045-985-281	
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					

Përgatiti: BASHKIM KRASNIQI

Nënshkrimi:

Data: 11/03/2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Malishevës
Opština Malisevo/Municipality of Malisevo
Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë
Njësia për Komunikim me Publikun



Lista e nënshkrimeve e qytetarëve pjesëmarrës në konsultim publik të RREGULLORES PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT
TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS për vitin 2022.

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1	Haris	KRYEZIU	BURIMUEC	Haris Kryeziu
2	Haris	Berisha	Gunbondh	Haris Berisha
3	Malisheva	Kryeziu	Bubare	Malisheva Kryeziu
4	Kotick	Behollu	Beltonice	Kotick Behollu
5	ASTIN	MORINA	Astanc	ASTIN MORINA
6	VALMIR	KAFERHOLLI	BELLANICE	VALMIR KAFERHOLLI
7	BARET	MORINA	ASTRAZUP	BARET MORINA
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				

Përgatiti: BASHKIM KRASTIRI

Nënshkrimi: Bashkim Krasiri

Data 28.03.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Malishevës
Opština Malisevo/Municipality of Malisevo
Drejtoria për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë
Njësia për Komunikim me Publikun



Lista e nënshkrimeve të zyrtarëve pjesëmarrës në konsultim publik të RREGULLORES PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT
TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS për vitin 2022.

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita e punës	Nënshkrimi
1	BASHKIM	KRASNIQI	DREJTOR I KADASTRE	
2	Fadil	Shala	Udhëheqës i DSHF	
3	Fidan	Shala	Drejtor i DKRS-së	
4	ACOTI	THAQI	Kryesues i Kuvendit	
5	Melisa	Alimaj	Udhëheqës i Shërbimit të Publikut	
6	RAMIZ	HORHA	ZYRTAR I URBANIZMIT	
7	Armond	Horha	Zyrtarë i Gjeodezisë	
8				
9				
10				

Përgatiti: BASHKIM KRASNQI

Nënshkrimi:

Data 28.03.2022



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E MALISHEVËS

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 24-03-2022
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 06/76

Me Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.01/361 të datës 10.03.2022, është themeluar komisioni për hartimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim me pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës. Ky komision ka hartuar draftin e parë të kësaj rregulloreje, prandaj bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Malishevës dhe nenin 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për Konsultime Publike, Rregullores për Transparencë të Komunës së Malishevës, me datë 24.03.2022 paraqet këtë:

NJOFTIM PUBLIK - FTESË

Konsultimi publik lidhur me Projekt – RREGULLOREN PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM ME PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUJTSHME TË KOMUNËS, do të mbahet me datë 28.03.2022, ditë e Hënë, në ora 13:00, në Sallën e Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Në këtë konsultim publik ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga secila drejtori e komunës, përfaqësues nga bizneset, Organizata Joqeveritare, si dhe çdo qytetarë i interesuar.

Parapakisht ju falënderojmë

Kryetari i Komisionit

Bashkim Krasniqi

E-mail: bashkim.k.krasniqi@rks-gov.net

Tel: 045/222/337



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Malishevës
Opština Malisevo/Municipality of Malisevo

PRANUAR MË:

PRILJENO:

29/03/22
01/468



Me Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.01/361 të datës 10.03.2022, është themeluar komisioni për hartimin e Draft – Rregullorës për përcaktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës. Ky komision përmes web – faqes së komunës e ka bërë publike draftin e kësaj rregulloreje. Me datë 24.03.2022 me anë të Njoftimit Publik Nr.06/76 ka caktuar datën dhe kohën e mbajtjes së konsultimit publik në Sallen e Kuvendit dhe ka bërë ftesë për pjesëmarrje për të gjithë të interesuarit.

Me datë 28.03.2022 në ora 13:00, është mbajtur konsultimi publik për këtë rregullore dhe në lidhje me diskutimet gjatë këtij konsultimi është hartuar ky:

PROCESVERBAL

Takimin e filloi Kryetari i Komisionit Bashkim Krasniqi, i cili pershendeti të pranishmit dhe i falenderoj për pjesëmarrje, e po ashtu prezentoj edhe dy anëtarët tjerë të këtij komisioni punues Z. Fadil Shala, nga Drejtoria e Sherbimeve Publike si dhe Z.Muharrem Morina, Udhëheqës i Shërbimit të Kuvendit.

Z. Krasniqi, sqaroi që hartimi i kësaj rregulloreje për dhënie në shfrytëzim të pronës më pak se një vit është në kompetencën e komunave sepse për dhënie në shfrytëzim për afat me të gjata procedurat janë të rregulluara me ligje dhe udhëzime administrative. Në vija të trasha elaboroj çështjet që do të rregullohen me këtë rregullore, procedura që duhet të zbatohet, pronat që mund të jepen në shfrytëzim, dokumentacioni i nevojshëm për aplikim si dhe çështje tjera që mbulohen nga kjo rregullore. Pastaj për t'i ju dhënë mundësin secilit që të japa idet, propozimet dhe të paraqet shqetësimet kryetari i komisionit e shpalli të hapur debatin.

Fjalën e kërkoj Z.Kastriot Kafexholli, nga Fshati Bellanicë, Drejtor i Klubit të Futbollit FC Malisheva, i cili deklaroi që e mirëpresin këtë takim, si dhe kërkoj që të bëhet një zgjidhje në lidhje me formën e shfrytëzimit të statiumit të qytetit nga ana e tyre, të gjinden modele edhe nga komunat fqinje në mënyrë që klubi të bëjë plane më afatgjata sidomos tash kur e dimë që tash klubi po kalon në një formë mjaft të mirë në superligë.

Pastaj fjalën e mori edhe Z. Haxhi Berisha, nga Fshati Carravranë, përfaqësues i Sindikatës së Punëtorëve të Arsimit në Malishevë, i cili po ashtu deklaroi që kryesia kësaj sindikate nuk ka një zyre të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të saj. Duke e ditur rendësin e kësaj sindikata, punën që kryen ka shumë nevojë që komuna në bazë të mundësive të na sigurojë një zyre ku mund t'i zhvillojmë aktivitetet dhe takimet tona.

Po ashtu fjalën e mori edhe Maliq Kryeziu nga Fshati Bubavec, i cili ngriti disa çështje. Ai deklaroi që meqënsë i përket një familjeje në mesin e shumë familjeve shqiptare, që ka familjar të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë, kërkojë që të vendoset një shenjë (pllakë) me të gjithë emrat e personave të zhdukur nga Komuna e Malishevës, si dhe të caktohet një zyre ku do të operojë Shoqata e të Zhdukurve, e cila zyre do ta lehtësojë veprimtarin dhe punën e kësaj shoqata dhe informimin e familjareve të të zhdukurve.

Pasi që nuk kishte me diskutim atëhere fjalën prap e mori Z. Krasniqi, Kryetari i Komisionit për t'u përgjigjur në lidhje me çështjet e ngritura.

Në lidhje me kërkesën e Drejtorit të Klubit FC Malisheva, deklaroi që Komuna e Malishevës është e përkushtuar për t'i mbështetur të gjitha klubet sportive në komunën tonë e veqanërisht ato që sjellin rezultate. Në kuadër të kësaj për mes kësaj rregulloreje mundemi që të fillojmë plotësimin e kërkesave tuaja e pastaj në vitet në vijim të planifikojmë diqka më afatgjatë.

Sa i përket kërkesës së përfaqësuesit të Sindikatës së Punëtorëve të Arsimit në Malishevë, është faktike që kjo sindikatë operon në një zyre private dhe do të bëjmë përpjeke që sipas mundësive të zgjidhet kjo çështje.

Ndërsa në lidhje me çështjet e ngritura nga diskutuesi tretë, Z. Krasniqi deklaroi që janë kërkesa shumë me vend dhe besoj që do t'i adresojmë dhe të bëjmë zgjidhje në një afat optimal.

Fjalën e kërkojë edhe anëtar i tjetër i komisionit punues Z. Fadil Shala i cili tha që kjo rregullore parasheh procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për afatin kohor me pak së një vit, ndërsa për afate tjera mi një vit e më shumë, duhet që procedura të zhvillohet përmes kuvendit dhe ankandit publik.

Pastaj fjalën e kërkojë edhe Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Z. Fitim Shala i cili deklaroi që sa i përket pllakës së të pagjeturve kjo çështje tashmë është në agjendën e kësaj drejtorie dhe besoj që do të përfundojë shumë shpejtë ndërsa mbetet i përkushtuar që kërkesat e klubeve sportive t'i shtyjë përpara deri në realizim.

Në fund pasi që me nuk kishte të lajmruar për diskutime, Z. Bashkim Krasniqi, i falenderoi të gjithë për prezencën dhe kohën që kanë ndar secili për të marrë pjesë në këtë konsultim publik.

Procesmbajtësi: Muharrem Morina

Nënshkrimi

Data 28.03.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

DRAFT

RREGULLORE

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK
SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

Malishevë, Mars 2022

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), lidhur me nenin 17 paragrafi 1 shkronja c), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008), e në mbështetje të nenit 6, pika 1, nënpika 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/2019), e konform nenit 7 të Rregullores nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 12 dhe 30 paragrafi 30.5 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Malishevës, , Kuvendi i Komunës së Malishevës, me datën _____ miraton këtë:

RREGULLORE (nr,_____) /2022

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret, kushtet dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për interes publik, për periudhen kohore më pak se një vit.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga organet e komunës, personat fizik dhe juridik në territorin e Komunës së Malishevës .

Neni 3

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin, siç është përkufizuar në Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet duke u bazuar në këto parime:

1.1. Parimi i ligjshmërisë - nënkupton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës duhet të bazohen në Kushtetutë, ligj dhe aktet e tjera nënligjore;

1.2. Parimi i efikasitetit - nënkupton se organet e komunës zhvillojnë procedurën për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, sa më shpejtë dhe sa më pak shpenzime për komunën dhe për palët, duke siguruar edhe qëllimin e dhënies së pronës për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal;

1.3. Parimi i trajtimit të barabartë të palëve - nënkupton se të gjitha palët në procesin e dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke shmangur çdo diskriminim ndaj palëve dhe duke vepruar në mënyrë objektive dhe të paanshme ndaj të gjithëve;

1.4. Parimi i transparencës - nënkupton se organet e komunës duhet të veprojnë me transparencë, të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e palëve për t'u informuar lidhur me procedurat, kushtet dhe ecurinë e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;

1.5. Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike të komunës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale është i detyruar që pronën ta shfrytëzojë në atë mënyrë që ta ruajë vlerën e saj dhe të përdorë të gjitha masat përkatëse për rritjen e kësaj vlere;

1.6. Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale, duhet ta shfrytëzojë pronën vetëm sipas destinimit të pronës duke ruajtur vlerat e saj kulturore, historike, arkeologjike, arkitekturën historike dhe çdo vlerë tjetër unike të saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit

1. Komunitat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit.

2. Pronat e paluajtshme të komunës të cilat mund të jepen në shfrytëzim për më pak se një (1) vit, janë:

2.1 Hapësirat publike, (parqet, sheshet, bulevardet, panot reklamuese, pishinat publike, brezi i rrugëve);

2.2 Shtëpitë e kulturës, kinematë, teatrot, sallat, stadiumet dhe terrenet rekreative-sportive;

2.3 Hapësirat publike para lokaleve;

2.4 Lokalet dhe prona e paluajtshme në pronësi të komunës;

2.5 Hapësirat publike rreth vend punishteve.

3. Kompensimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit përcaktohet me rregullore të komunës për taksa komunale.

Neni 6

Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit jepet, duke u bazuar në kriteret vijuese:

1.1 Të jetë e regjistruar si pronë e komunës në regjistrat kadastrale të pronës;

1.2 Të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta;

1.3 Të mos ketë ndonjë kontest pronësor;

1.4 Të jetë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor

1.5 Të plotësoj kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore;

1.6 Të ketë arsyeshmërinë të interesit publik;

1.7 Të ndikojë në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë;

1.8 Të ndikojë në rritjen e vlerave e diversitetit arsimor, kulturore-sportiv e të ngjajshme.

Neni 7

Procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit

1. Prona e paluajtshme e komunës jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët shprehin interesim përmes një kërkesë zyrtare me shkrim.
2. Kërkesa duhet t'i drejtohet organin kompetent, drejtorisë përkatëse:
 - 2.1. Për dhënien në shfrytëzim të hapsirave publike, kërkesa i drejtohet drejtorisë për shërbimeve publike;
 - 2.2. Për dhënien në shfrytëzim për objektet kulturore, rinore dhe sportive, kërkesa i drejtohet drejtorisë për kulturë, rini dhe sport;
 - 2.3. Për dhënien në shfrytëzim të lokaleve dhe pronës së paluajtshme në pronësi të komunës, kërkesa i drejtohet drejtorisë për gjeodezi kadastr dhe pronë;
 - 2.4. Për dhënien në shfrytëzim të hapsirave publike rreth vend punishteve, kërkesa i drejtohet drejtorisë për urbanizem;
3. Prona e cila jepet në shfrytëzim mbi bazën e kërkesës së aplikuesit duhet të shfrytëzohet vetëm për destinimin e kërkuar.

Neni 8

Kushtet për aplikim

1. Personat fizik dhe juridik me rastin e aplikimit për të marrë në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës duhet të bashkangjesin këto dokumente:
 - 1.1. Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara nga drejtoria përkatëse;
 - 1.2. Kopja e lehtënjofimit për personat fizik;
 - 1.3. Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik;
 - 1.4. Veprimtaria që do të zhvillojë;
 - 1.5. Projekti ideor;
 - 1.6. Vërtetimi nga komunat për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë dhe taksave komunale;
 - 1.7. Certifikata e pronës dhe kopja e planit për hapsirën e kërkuar.
2. Në rast se dokumentet të cilat kërkohen në aplikimin për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nuk janë të kompletuara, kërkesa refuzohet nga ana e drejtorisë përkatëse.

Neni 9

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për Organizatat e shoqërisë civile

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së komunës për organizatat e shoqërisë civile për periudhën më pak se një (1) vit jepet me procedura të njëjta siç është përcaktuar me këtë rregullore.
2. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për organizatat e shoqërisë civile jepet nga një (1) ditë deri në dhjetë (10) ditë të cilat kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarive në kuadër të kompetencave vetanake të komunës, për promovimin e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, sportive, rinore, arkitekturën historike, e të ngjashme.
3. Organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë për qëllim ushtrimin e aktiviteteve të cekura në paragrafin 2 të këtij neni prona e paluajtshme iu jepet në shfrytëzim vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlersues.
4. Organizatat e shoqërisë civile të cilat ushtrojnë veprimtarinë apo aktivitetet rehabilituese për personat me nevoja të veçanta, prona e paluajtshme e komunës mund të iu jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit, vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlersues.

Neni 10

Formimi dhe përbërja e komisionit

1. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për secilën drejtori e cila në bazë të kësaj rregulloreje ka kompetencë dhe autoritet të jep në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës.
2. Komisioni do të ketë përbërje, prej tre (3) anëtarëve, ku kryesues i komisionit do të jetë zyrtari nga drejtoria së cilës i është drejtuar kërkesa për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ndërsa dy anëtar mund të jenë nga drejtoritë tjera të fushave profesionale.
3. Komisioni ka për obligim që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës të bëjë shqyrtimin e kërkesës, të konstatojë gjendjen faktike në teren, se a është në harmoni dhe përputhshmëri me arsyeshmërinë e kërkesës.
4. Pas shqyrtimit të kërkesës, komisioni duhet të bëjë raport përfundimtar dhe të rekomandojë për palën përfituese.
5. Mandati i komisionit do të jetë dy (2) vite.

Neni 11

E drejta e ankesës

1. Pala e pakënaqur kundër procesit të vlersimit të kërkesës ka të drejtë ankese në komisionin e ankesave të komunës, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
2. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave ;
3. Përbërja e komisionit do të jetë prej pesë (5) anëtar, ku njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë jurist, ndërsa të tjerët profesionist sipas drejtorive përkatëse.
4. Vendimi i komisionit të ankesave për miratimin apo refuzimin e ankesës së palës është përfundimtar në procedurën administrative në komunë.
5. Komisioni për ankesa brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të ankesës bën shqyrtimin e ankesës;
6. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave brenda afatit ligjor prej tridhjetë ditësh (30) nga dita e marrjes së vendimit, mund të inicojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.
7. Mandati i komisionit për shqyrtimin e ankesave do të jete dy (2) vite.

Neni 12

Konflikti i interesit

1. Anëtarët e Komisionit përjashtohen nga procesi vendimmarrës nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
2. Anëtarët e Komisionit vlerësues përjashtohen nga procesi vlerësues nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
3. Anëtarët e Komisionit për shqyrtimin e ankesave përjashtohen nga procesi i shqyrtimit të ankesave nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 13

Nënshkrimi i kontratës

1. Bazuar në rekomandimin e komisionit vlerësues dhe pas kalimit të afatit të ankesës, Kryetari i Komunës nënshkruan kontratën me të përzgjedhurin, në të cilën kontratë përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
2. E drejta e shfrytëzimit e pronës së paluajtshme të komunës më pak se një vit, nuk mund të bartet te personat e tretë.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 14

Mbikqyrja e kontratës

1. Drejtoria përkatëse bën mbikqyrjen e realizimit të kontratës se a është duke e shfrytëzuar pala sipas kushteve të kontratës.
2. Në rast të mos përmbushjes së kontratës, apo shmangies nga qëllimi për të cilën është marrë prona në shfrytëzim sipas kërkesës së palës, drejtoria përkatëse do të përgatis raport përfundimtar me të cilin do të rekomandoj Kryetarin e Komunës për shkëputje të njëanshme të kontratës.
3. Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të raportit përfundimtar të përgaditur nga drejtoria përkatëse dhe duke u bazuar në rekomandimin e dhënë do ta shkëpus kontratën në mënyrë të njëanshme, duke e njoftuar shtatë (7) ditë para ndërprerjes së kontratës palën kontraktuese.
4. Komuna është e obliguar që të publikojë listën e pronave të cilat i kanë dhënë në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
5. Publikimi i listës së pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim bëhet brenda shtatë (7) ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Neni 15

Mirëmbajtja e pronës së komunës

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pronës komunale, janë të detyruar që ato t'i mirëmbajnë dhe t'i shfrytëzojnë në mënyrën e caktuar konform kontratës për shfrytëzim;
2. Personat fizik dhe juridik dhe të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të komunës, janë të detyruar të kujdesen për mbrojtjen e pronës së paluajtshme, ashtu siç parashihet me këtë Rregullore.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen Rregulloret dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Malishevës të cilat bien ndesh me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 17
Konflikti me ligjin

Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe akteve tjera nënligjore që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 18
Zbatimi

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive të Komunës së Malishevës.

Neni 19

Hyrja në fuqi

1 Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040 për vetëqeverisje lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores-Nr-01/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave dhe pas shpalljes në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Nr- 02/ _____

Kryesuesi i Kuvendit

Data _____



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

PRANUAR ME
ACCEPTED
PRIM. JEND
M. Nr. 01/379.
11/03/2022

Për: Kryetarin e Komunës së Malishevës – Z. Ekrem Kastrati

Nga: Komisioni për hartimin e Draft - Rregullore për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për përiudhën kohore më pak se një vit

Lënda: Shkresë përcjellëse

Datë 11.03.2022

I nderuar

Komisioni për hartimin e Draft - Rregullore për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për përiudhën kohore më pak se një vit, i formuar me Vendimin Nr.01/361 të datës 10.02.2022, ka punuar në lidhje me këtë rregullore dhe ka hartuar draftin e parë.

Bazuar në kompetencat që ka Komuna e Malishevës, ky komision ka punuar në hartimin e kësaj rregulloreje në harmoni me nenin 11 dhe 12.2 shkronja c), lidhur me nenin 17 paragrafi 1 shkronja c), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008), e në mbështetje të nenit 6, pika 1, nënpika 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/2019), e konform nenit 7 të Rregullore nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe nenit 30 paragrafi 30.5 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Malishevës.

Prandaj, përmes kësaj shkrese po ju përcjellim draftin e parë të kësaj rregulloreje për procedurat e metejme të plotësimit, ndryshimit dhe miratimit në Kuvend.

Bashkim Krasniqi

KOMISIONI

Muhammed Morina

Fadil Shala

Adresa: Rr. "Skenderbahu" P.nr
24000 Malishevë



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNË E MALISHEVËS
THE MUNICIPAL ASSEMBLY OF MALISHEVE - OPSTINA OPSTINE MALISHEVO



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë: 09/02/2022

PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

10/03/2022

01/361

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja g dhe h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) Udhëzimin Administrativ nr.03/2013, për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Rregulloren nr.02/2021, për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, neni 5,6 dhe mbështetur në Statutin e Komunës së Malishevës, neni 12,

Kryetari i Komunës me datë 09.02.2022 mori këtë;

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E DRAFT-RREGULLORËS PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE PËR PERIUDHËN KOHORE MË PAK SE NJË VIT

I. Formohet komisioni për, Hartimin e draft-Rregullores për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për periudhën kohore më pak se një vit.

1 I. Komisioni formuar sipas nenit 1 të këtij vendimi, është në përbërje me emrat e zyrtarëve të cekur si më poshtë;

- 1. Bashkim Krasniqi-Kryetar i komisionit,
- 2. Muharrem Morina- anëtar,
- 3. Fadil Shala- anëtar.

1 I I. Ky komision është i obliguar të bëjë draftimin e parë të Rregullores për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për periudhën kohore më pak se një vit. Pas përfundimit të draftit të parë, do të procedohet në organet tjera kompetente të cilat janë të autorizuar me ligj.

I V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës

Ekrëm Kastrati

Vendimi ju dorëzohet:

- 1. Komisionit
- 2. Arkivit të komunës